

# ÇËSHTJE TË ZHANRIT DHE ESTETIKËS NË POEZITË E NDRE MJEDËS

Adil OLLURI

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës  
Prishtinë

## 1. Kërkimi i zhanrit

Sa herë që përpiqemi të përcaktojmë zhanrin e një teksti a veprë letrare, duhet të kemi parasysh faktin se ai nuk është kategori abstrakte, por një kategori konkrete që përcaktohet përmes analizimit të strukturës, principit të shkrimit dhe tematikës së tekstit a veprës. Përmes këtij analizimi ai bëhet pjesë e një lloji të caktuar tekstesh, që janë të dallueshme prej llojeve të tjera. Pra, zhanri nënkupton llojin e një teksti a veprë letrare. Nga ky kënd sot do t'i shohim krijimet poetike të Ndre Mjedjes, duke iu referuar kryesisht përmbledhjes *Juvenilja* (Rilindja, Prishtinë, 1990). Ndër zhanret kryesore që mund të takojmë në këtë përmbledhje poetike janë poema, poemthi, soneti, lirika nacionale, përkushtuese, lirika sociale, lirika e peisazhit etj. Sipas këtij tipologjizimi, këto krijime mund t'i përcaktojmë si krijime në thelb lirike. Duke kujtuar se lirizmi është tipar i romantizmit, mund të themi se në thelb Mjeda është lirik, madje lirik i

llojit të veçantë.

Analizën po e fillojmë me krijimin poetik *Vaji i bylbylit*, i cili mendojmë se nuk i takon zhanrit të poemës, siç e përcaktojnë shumë kritikë, por zhanrit të poemthit. Këtë e themi sepse poema është zhanër narrativ, rrëfimtari, ku narrativja vihet në qendër të objektivit, ndërsa lirizmi përdoret vetëm për formësimin e diskursit. Kjo nuk ndodh te poemthi, përkundrazi këtu lirizmi vihet në qendër të objektivit. I tillë është ky krijim i Mjedës. Arsyeja e dytë pse nuk mund ta quajmë këtë krijim poemë është shkak i shkurtësisë strukturore, e cila është atipike për strukturën e poemës. Dhe së treti, ne kemi bërë një lexim krahasues të *Vajit të bylbylit* me tri vepra që janë thelbësore për nga modeli i poemës së romantizmit, si *Çajld Haroldi* i Bajronit (Rilindja, Prishtinë, 1977), *Eugjen Onegini* i Pushkinut (LMG-Argeta, Tiranë, 2001) dhe *Atta Trolli* i Hajnes (Rilindja, 1981), ku kemi vërejtur se ndërmjet tekstit të Mjedës dhe këtyre poemave ka më shumë dallime se sa ngjashmëri.

Pasiqë, e përcaktuam këtë krijim poetik të Mjedës si poemth, atëhere duhet të bëjmë përpjekje që ta tipizojmë, ta përcaktojmë se në cilin lloj mund të vendoset ky krijim poetik. Në këtë aspekt janë bërë shumë kërkime nga kritika jonë letrare, që duke e interpretuar temën dhe qëllimin e këtij poemthi kanë ardhur deri te një tipizim i tij direkt apo indirekt. Por, ne do përmendim tri mendime që do të na ndihmojnë në specifikimin e problemit me të cilin merremi. Mendimi i parë vjen nga Tirana, i shprehur në librin *Historia e letërsisë shqiptare* (grup autorësh, botim i Akademisë së Shkencave të RPSSH-së, ribotim i Rilindjes, Prishinë, 1989), mendim i cili e interpreton *Vajin e bylbylit* si tekst me temë nacionale, dhe si rezultat nxirret tipizimi i tij si *poemth patriotik*. Mendim krejt të kundërt, alternativ me këtë, ka akademik Sabri Hamiti, i cili e interpreton këtë krijim të Mjedës si tekst personal (*Studime letrare*, ASHAK, 2003). Duke e interpretuar temën personale, autobiografike të këtij teksti, ai nxjerr si rezultat tipizimin e tij si poemë autobiografike. Pajtohemi me mendimin e akad. Hamitit mbi përmbajtjen personale e autobiografike të këtij teksti, por nuk pajtohemi me tipizimin e tekstit si poemë, sepse siç e cekëm edhe më lart, ky tekst nuk i përmbahet kriterve llojore të poemës. Dhe ne, në pajtim me interpretimin tematik të akademik Hamitit do ta tipizojmë si poemth

autobiografik. Një mendim pak më alternativ se dy mendimet e para, e shpreh akademik Rexhep Qosja (*Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi III*, Rilindja, 1986), i cili nuk është aq i prerë, aq këmbëngulës në përcaktim si dy të parët, por na lë të hapura dy mundësi, dy oferta, duke e interpretuar edhe si tekst me temë personale, edhe si tekst me temë nacionale e ngjyrim alegorik. Këtu edhe rezultati tipizues është relativ.

Pasi i pamë këto interpretime tematike e tipologjike, ne vlerësojmë se ky tekst i takon tipit të poemthit alegorik për shkak të principit alegorik të shkrimit, që është mbizotërues në të. Sidoqoftë, tema e tij, personale apo atdhetare (impersonale), realizohet përmes këtij principit alegorik e jo principit simbolik, siç theksohet në disa studime (shih: *Historia e letërsisë shqiptare*, grup autorësh, Rilindja, 1989, fq. 344). Ne mendojmë se në këtë princip është më së miri të lexohet ky poemth. I afërt strukturalisht me *Vajin e bylbylit* është krijimi tjetër poetik i Mjedës *I tretuni*, që i përgjigjet zhanrit të poemthit, por që në dallim prej të parit, nuk është i realizuar në principin alegorik dhe ka një temë shoqërore, mërgimin. Si i tillë mund të përcaktohet si poemth shoqëror.

Zhanër tjetër është poema *Andrra e jetës*, e cila ka një temë shoqërore që ndërtohet në një princip thjesht romantik, ku poema ka një vision kristian mbi jetën. Nuk është i rastë-

sishëm numri tre i personazheve. Pasi, poema ka një përmbajtje shoqërore, atëherë ajo mund të tipizohet si poemë shoqërore. Te Mjeda përfaqësohet zhanri i sonetit me tekstet *Lirija*, *Lissus*, *Scodra*. Por, pasi e dimë se soneti është vetëm formë e organizimit strukturor, atëhere për përcaktimin kategorik na duhet edhe diçka tjetër. Për nga këndi i përmbajtjes këto janë sonete (tingëllima) nacionale, ndërsa nga këndi i poetikës apo principit të shkrimit, veçanërisht *Lissus* dhe *Scodra* janë sonete neoklasike. Edhe Mjeda, si neoklasikët e mëdhenj Kornej dhe Rasini, udhëton nëpër antikitet për t'i formëzuar temat e tij, temat antike, që ishin tema ideale për neoklasikët.

Ndër zhanre të tjera paraqitet lirika sociale, që përfaqësohet me poezinë *I mbetuni*, që ka për temë varfërinë. Poezitë *Vorri i Skanderbegut* dhe *Gjuha shqype* (*Gustav Meyerit*) qëndrojnë midis lirikës përkushtuese dhe lirikës nacionale. Shembull për këtë mund të marrim poezinë *Vorri i Skanderbegut*, ku në fillim duket si poezi kushtuar heroit të madh, ndërsa me një lexim të vëmendshëm kuptojmë se poezia ka për temë varrin e heroit, si shenjë e kujtesës dhe identitetit nacional. I njëjti princip është i pranishëm edhe te poezia *Gjuha shqype* (*Gustav Majerit*). Poezitë e Mjedës kanë edhe një zhanër tjetër, atë të *lirikës së peisazhit*, që përfaqësohet me poezitë *Prendvera*, *Vera*, dhe *Vjeshta*, *Dimni*. Te poezia e fundit, *Dimni*, është i pranishëm dimension

social, kështu që lirisht mund të thuhet se kjo poezi mund të qëndrojë në mes të lirikës peisazhore dhe lirikës sociale. Kurse, poezia *Bashkonju* i përket zhanrit të lirikës kushtrimore, apelative dhe ka një ligjërim të theksuar deklarativ.

## 2. Estetika-kërkimi i saj

Të kërkosh estetikën, të bukurën, në një vepër letrare nuk është proces aq i lehtë, sepse pikësëpari estetika është dije sintetike dhe i interesojnë të përgjithshmet e artit, pra nuk merret me një vepër të veçantë. Së dyti, perceptimi estetik jo rrallëherë është i imponueshëm nga faktorët e jashtëm, si faktori kohë me kërkesat e saj estetike dhe faktori lexues me formimin dhe pritshmërinë e tij estetike, apo siç do të thoshte H.R. Hausi me horizontet e tij të prirjes.

Më gjithatë, ne do të provojmë t'i vëmë në pah kategoritë estetike në poezitë e Mjedës. Së pari, po provojmë ta përcaktojmë kategorinë e *së bukurës* në poezitë e tij. Për ta bërë këtë duhet të kemi parasysh formimin estetik dhe kulturor të Mjedës, poetikën e shkrimit, strukturën e vargut etj. Dihet se ai kishte një formim letrar klasik në kuadër të teorisë dhe estetikës së antikitetit grek e romak, e ky formim shfaqet edhe në krijimtarinë e tij poetike. Sipas teorive klasike, e bukura në art vlerësohej sipas simetrisë dhe harmonisë së strukturave. Kjo e bukur varet nga raporti konkret që vendoset midis një sendi dhe sendeve

tjera berenda kësaj strukture (Alfred Uçi, *Probleme të estetikës*, 1980). Në antikën greke janë të njohura dy kanone përmes të cilave mund ta shpjegojmë të bukurën në artet klasike, njëra është *Poetika* e Aristotelit (të cilën e njohim të gjithë) dhe e dyta, kanoni estetik i Polikletit i quajtur *prerje e artë*, ku theksohet se vetëm proporcioni matematik i pjesëve shpreh të bukurën, formën e përkryer (A. Uçi, Rilindja, 1980, fq.16). Nisur nga leximi i vëmendshëm i strukturave të poezive të Ndre Mjedës, mund të vërejmë se strukturat e tyre kanë një harmoni dhe rregullsi klasike. Pra, këtu qëndron e bukura e poezive të tij, në harmoninë e pjesëve, në format precize, në qartësinë e shprehjes, qartësi e cila e bën Mjedën proaristotelian. E bukura në poezitë e tij qëndron edhe te pastërtia e shprehjeve dhe tematikave. Vetë Mjeda në shkrimin e tij teorik *Përmbi poezi përgjithësisht* (Mjeda, *Vepra II*, Rilindja, Prishtinë, 1982), e shpall pastërtinë si qëllim në vete për poezinë. E bukura klasike gjendet te shumica e poezive të Mjedës, pa mundur ta garantojmë tek të gjitha.

Përveç të bukurës, si kategori themelore estetike, në poezinë e Mjedës është e pranishme kategoria e së madhërishtes, e cila veçanërisht shprehet te sonetet *Lissus*, *Scodra*, dhe te poezia *Vorri i Skanderbegut*. Te sonetet, kjo kategori shprehet me madhështinë e qyteteve dhe lashtësisë sonë deri në përmasat mitologjizuese, ndërsa te poezia kjo kategori shprehet te madhë-

shtia e heroit dhe efekti nacional i varrit të tij.

Si kategori tjetër paraqitet *tragjika*, e cila është e pranishme në shumë poezi të Mjedës, por më së qarti shprehet te poema *Andrra e Jetës* dhe poemthi *Vaji i bylbylit*. Te *Andrra e jetës*, kjo kategori shprehet nëpërmjet tragjikës jetësore të paraqitur në poemë, tragjikë që ka ngjyrimë kristiane, e cila më së miri shprehet nëpërmjet figurës së Tringës. Ndërsa, te *Vaji i bylbylit* është i pranishëm edhe koncepti aristotelian i *fajtorit të pa faj*. Këtë mund ta argumentojmë përmes vargjeve të këtij poemthi:

*Vet bukurija, o i mjeri  
Kenka për ju një kob"*

Në këto poezi shfaqen edhe kategoritë estetike *e mira* dhe *e keqja*. E mira është e barazvlershme me etikën, të ndershtmen, dhe kjo më së miri shprehet përmes figurës së Zogës te *Andrra e Jetës*, dhe gjakimit të saj për një dashuri të ndershme, ideale. E keqja si antipod i së mirës, paraqitet theksueshëm te poezia *Mustafpasha në Babune*, ku kjo e keqe e pashait, shihet me një sy kritik. Është me vend të thuhet se e shëmtuara dhe komikja nuk janë të pranishme në poezitë e Mjedës, kjo për shkak të formimit të tij estetik e intelektual. E shëmtuara nuk shfaqet për shkak të formimit të tij klasik e neoklasik, i cili nuk e pranonte të shëmtuarën në art, ndërsa komikja nuk shfaqet për shkak të formimit të tij kristian, i cili nuk e pranonte komiken.